

VENDIM
Nr.71, datë 2.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““

me sekretare Drita Filto, më datë 29.10.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.50 Akti që i përket:

K Ë R K U E S A: HASAN DOÇI, GJELOSH KOLA, VERA NARKAJ, MARTIN LIVADHI, MIRASH GURALECI, MIRASH LAMI, NDOC MOLLI, DYLEJMAN RAJTA DHE RAMIZ DAMZI, të përfaqësuar nga avokat Dedë Pali.

SUBJEKT I INTERESUAR : NDËRMARRJA E UJRAVE LEZHË, në mungesë.

O B J E K T I : Deklarimi antikushtetues i vendimeve nr.713, datë 31.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.354, datë 18.3.1998 të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesit kanë parashtruar përpara kësaj Gjykate këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Kasacionit.

Është shkelur parimi i barazisë së shtetasve përpara ligjit;

Gjykata e Apelit dhe e Kasacionit nuk e kanë zgjidhur çështjen drejt në përputhje me ligjin dhe me provat e administruara;

Gjykimi në Apel është zhvilluar në mungesën tonë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës, përfaqësuesin e kërkuesve dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e rrethit Lezhë, mbi padinë e ngritur nga kërkuesit ka vendosur detyrimin e Ndërmarrjes së Ujrave Lezhë, të paguaj në favor të tyre vlerën e dëmit të shkaktuar në të mbjella, si rrjedhojë e përmytjeve nga rreshjet në fshatin Balldre të rrethit Lezhë.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.713, datë 31.1.1997, ka rrëzuar padinë e kërkuesve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.354, datë 18.3.1998.

Pretendimi i kërkuesve se është shkelur parimi i barazisë së shtetasve në ligj dhe para ligjit, me arsyetimin se 65 personave nga ky fshat në procese analoge, për të njëjtin shkak, me të njëjtin objekt dhe palë, gjykatat ju a kanë njohur dëmin e shkaktuar, nuk është i drejtë. Neni 25 i ligjit Kushtetues për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, parashikon se të gjithë shtetasit janë të barabartë në ligj dhe para ligjit dhe ndalon diskriminimin e tyre për shkak të seksit, racës, etnisë, gjuhës, bindjeve politike etj.

Barazia në ligj dhe para ligjit, nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike të ketë zgjidhje të njëjtoja nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive, apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjtoja.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Dhe unifikimi i praktikës gjyqësore, nuk duhet kuptuar se e ka burimin nga parimi i barazisë së shtetasve në ligj dhe përpara ligjit, por i shërben gjykatave të zakonshme, që gjatë punës së tyre të

mbajnë qëndrime të njëjta dhe të përafërta për kuptimin dhe zbatimin e drejte të ligjeve, pa injoruar provat dhe të gjitha rrethanat e tjera të çdo çështjeje konkrete.

Pikërisht për këto arsye, si dhe nga të gjitha provat e tjera që ndodhen në dosjen gjyqësore, Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se kërkuesve nuk u duhej pranuar padia, por u duhej rrëzuar, duke mos patur aspak detyrimin ligjor për ti dhënë kësaj çështjeje të njëjtën zgjidhje si edhe çështjeve të tjera.

Pretendimi i kërkuesve lidhur me zhvillimin e gjykimit në mungesë nga ana e Gjykatës së Apelit, nga ballafaqimi me të gjitha materialet e dosjes, nuk vërtetohet, për arsye se procesverbali i seancës gjyqësore të datës 31.1.1997, i mbajtur nga sekretarja e seancës dhe i nënshkruar nga tre anëtarët e trupit gjykues pasqyron të kundërtën. Sipas këtij procesverbali, rezulton se janë thirrur dhe paraqitur palët në këtë datë të zhvillimit të seancës gjyqësore.

Në këto rrethana, kërkesa e paraqitur nga kërkuesit nuk duhet të pranohet, sepse nuk gjen mbështetje në dispozitat kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në bazë të nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.